



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 13.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 61/2012, “PËR AKCIZAT NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”
(shqyrtimi në parim)

HYRJE

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, shqyrtoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, në mbledhjet e datave 6,7,8,9, dhe 13 nëntor 2018.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, bazuar në Kalendarin e posaçëm të Kuvendit për shqyrtimin e projektbuxhetit të shtetit të vitit 2019 dhe projektligjeve financiare që kanë lidhje me të.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Ilir Beqaj relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, është një nismë e Këshillit të Ministrave, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit bazuar në përcaktimet e nenit 78, 83, pika 1 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ky projektligj është pjesë e paketës fiskale 2019.

Projektligji shoqërohet nga Shtojca 1, si pjesë përbërëse e tij dhe nga relacioni shpjegues, sipas përcaktimeve të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Të pranishëm në mbledhjet e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin Z. Erion Luçi, zëvendësministër i ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

I. QËLLIMI DHE PËRMBJATJA E PROJEKTLIGJIT

➤ Ndryshimet në projektligj

Projektligj synon:

1. Ndryshimin e nivelit të akcizës për produktin e duhanit të grirë, purot, cigarillos dhe cigaret me zëvendësues duhani;

Propozohet të rritet niveli i akcizës për kategorinë T400 “Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit”, në masën 6000 lekë/kg nga 4400 lekë/kg që është aktualisht.

Kjo rritje akcize propozohet:

- Me qëllim barazimin e taksimit të produkteve të kësaj kategorie me kategorinë T200 “Cigare që përmbajnë duhan”, më 1 janar 2019, pasi referuar edhe të dhënave për shtete të tjera të rajonit (Kosovë dhe Maqedoni), rezulton se për këto dy kategori (T200 dhe T400), niveli i taksimit për njësi konvencionale është i njëjtë.
- Me qëllim përafrimin e mëtejshëm me Direktivën e BE 2011/64, e cila përcakton nivelin minimal të akcizës për duhanin e grirë të paktën 60 euro për kg, riskedulimi i rritjes siguron një politikë të qëndrueshme taksimi sipas standardeve të BE-së.
- Pasi konstatohet se përqindja e akcizës në çmimin përfundimtar të duhanit të tymosshëm, të grirë në Shqipëri zë një peshë më të vogël në krahasim me vendet e tjera të rajonit dhe vendet e rajonit, bazuar në të dhënat e vitit 2017.
- Meqenëse rritja e akcizës për cigaret është një nga politikat e përdorura për frenimin dhe uljen e konsumit të cigareve nga popullata si produkt me efekte negative në shëndet, duke rritur çmimin e shitjes së tyre.

Efekti që do të sjellë në të ardhurat e buxhetit të shtetit rritja e nivelit të akcizës për këtë kategori parashikohet të jetë +140 milionë lekë.

1.1. Propozohet të rritet niveli i akcizës për kategoritë T300 dhe T500 “Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani”, nga 4400 lekë/kg, në 6000 lekë/kg.

Kjo rritje e nivelit të akcizës propozohet me këto argumente:

- Purot dhe cigarillos janë produkte me konsum të ulët dhe nga shtresa me të ardhura të larta, ndërkohë që aktualisht kanë nivel të njëjtë taksimi me duhanin e grirë, që konsumohet gjerësisht dhe nga shtresa me të ardhura më të ulta;

- Tregtimi i purove dhe cigarillos ka nevojë për korrektim dhe standardizim të produkteve të akcizës që përmbajnë duhan. Puro dhe cigarillos janë produkte luksi dhe për këtë qëllim rritja e nivelit të taksës vjen në të njëjtën linjë me qëllimin e taksës së akcizës.
- Me qëllim barazimin e taksimit të produkteve të kësaj kategorie me kategorinë T200 “Cigare që përmbajnë duhan”, më 1 janar 2019, pasi referuar dhe të dhënave nga shtete të rajonit (Kosove, Maqedoni), rezulton se për këto kategori (T200, T300 dhe T500), niveli i taksimit për njësi konvencionale është i njëjtë.

Efekti që do të sjellë në ardhurat e buxhetit të shtetit rritja e nivelit të akcizës për këtë kategori parashikohet të jetë +3.8 milionë lekë.

- 1.2. Propozohet të shtohet kategoria T402 “Duhan me ngrohje” në kreun 2403, kodi tarifor 2403 90 90 me akcizë 6000 lekë/kg.

Arsyeja për shtesën e kësaj kategorie në listën e mallrave të akcizës është se në tregun vendas do të tregtohet një produkt i ri, “duhan me ngrohje”. Referuar njoftimit dhe kërkesës së kompanisë përkatëse, tregtues të këtij produkti, për krijimin e një formati të ri pulle akcize për produktin “Duhan me ngrohje”, në sistemin SICPATRACE.

2. Detajimin e Kategorisë T401 në rubrikën shkalla e taksimit, nga “10 lekë/ml” në “10 lekë/ml të totalit të litrave brenda ambalazhit”.

Nevoja për saktësim në rubrikën taksim të shtojcës nr. 1 të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, duke shtuar “totalit të litrave brenda ambalazhit” lind për shkak të problematikave të hasura gjatë zbatimit të këtij niveli taksimi nga struktura të ndryshme zbatuese, mbikëqyrëse si dhe kontestime nga subjektet importuese, lidhur me mënyrën e taksimit të këtij produkti, konkretisht me metodikën e përlllogaritjes së detyrimit të akcizës mbi totalin e litrave që përmban produkti i gatshëm (lëng+nikotinë lëng) dhe jo vetëm përqindjen e nikotinës lëng në produkt.

3. Heqjen nga lista e mallrave të akcizës për fishekzjarrët, llambat dhe pilat/bateritë në Kategoritë F000, A100 dhe Y100.

Ky propozim vjen me argumentet:

- Nga pikëpamja doganore, importuesit paguajnë akcizën në momentin e importimit dhe nuk kanë më procedurë tjetër mbikëqyrjeje, pra nuk jepen autorizime për këto produkte;
- Menaxhimi i produkteve të tilla është i vështirë sepse, për shkak të specifikave, ato janë lehtësisht të transportueshme dhe, për arsye të ngarkesës fiskale me akcizë, rritet interesi i operatorëve për kontrabandë;

- Heqja e këtyre produkteve nga lista e mallrave të akcizës do të ndihmojë në uljen e interesit të operatorëve për të kryer kontrabandë, me qëllimin që të deklarojnë sasinë reale. Në këtë mënyrë do të arkëtohen më shumë të ardhura në TVSH dhe taksë doganore.

Efekti që do të sjellë ky propozim në të ardhurat nga akciza parashikohet të jetë -40 milionë lekë, por ka një pritshmëri të rritjes së sasive të deklarimeve për këto produkte, duke sjellë kështu rritje të të ardhurave nga TVSH-ja dhe taksat doganore.

4. Heqjen nga lista e mallrave të akcizës, të produktit “rërë bituminoze” me kod 27 14 10 00.

Propozimi për heqjen nga lista e mallrave të akcizës, të produktit rërë bituminoze, i cili aktualisht akcizohet në masën 2 lekë/kg, vjen me arsyet e mëposhtme:

- Rëra bituminoze nuk mund të përdoret si lëndë djegëse zëvendësuese, pasi përmbajtja e bitumit është 6-9%;
- ka çmim 3 herë më të ulët se “zhavorri bituminoz”;
- përdoret vetëm për shtresat asfaltike të varfra.

5. Vendosjen e akcizës për produktin “zhavorr bituminoz” në masën 1 lekë/kg për produktin “Zhavorr bituminoz”, me kod 27 14 90 00.

Vendosja e akcizës për këtë produkt propozohet me këto argumente:

- Përdorimi gjithnjë në rritje i lëndëve djegëse zëvendësuese në industrinë e prodhimit të tullave e të çimentos, që, sipas NKM-së klasifikohen në Kapitullin 27 “Lëndët djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e distilimit të tyre, substancat bituminoze, dyllët minerale”, dhe pikërisht në kodin “27 14 90 00”, me përshkrim “zhavorr bituminoz”.
- Referuar interpretimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), këto produkte njihen teknikisht me emrin “qymyr bituminoz (bituminous coal)” dhe sipas AKBN-së, këto produkte kanë një përmbajtje squfuri që varion nga 5% - 6%, përmbajtje karboni nga 42% - 44%, si dhe lëshojnë në atmosferë hire djegës në nivelin 25% - 35%. Ligji nr.61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikën 1 dhe 3, të nenit 50, ka parashikuar se konsiderohen produkte energjetike produktet që klasifikohen në kodet NK 27 01 27 02 dhe 27 04 deri në 27 15 dhe i nënshtrohen pagesës së akcizës, sipas të njëjtit nivel akcize” çdo produkt “që përdoret si zëvendësues, mbushës ose shtues për lëndët djegëse, ose karburantet.

Produkti “zhavorr bituminoz” me kod NK 27 14 90 00, bën pjesë tek produktet e klasifikuara në pikën 1, të nenit 50, dhe si i tillë, ky produkt, duhet t’i nënshtrohet pagesës së akcizës në të njëjtin nivel me produktin që zëvendëson, kur përdoret si zëvendësues për lëndët djegëse. Aktualisht, mbi koksin e naftës, aplikohet akcizë në masën 2 lekë/kg dhe taksë karboni 3

lekë/kg, duke përfaqësuar një ngarkesë fiskale në masën 40% mbi çmimin e shitjes. Ndërkohë për zhavorrin bituminoz propozohet të vendoset akciza në masën 1 lekë/kg, duke ruajtur në këtë mënyrë të njëjtën ngarkesë fiskale me produktin që zëvendëson.

Efekti në të ardhurat e buxhetit të shteti, me vendosjen e kësaj akcize, parashikohet të jetë +40 milionë lekë.

6. Shtimin e produktit “duhan i grirë”, në pikën 5, të nenit 41 “Aplikimi i pullave fiskale”,

Kjo bëhet me qëllim për të disiplinuar qarkullimin e duhanit të grirë dhe për të respektuar përcaktimet e ligjit nr. 8691, datë 16.11.2000, “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, neni 17, i të cilit përcakton se : “Produktet e duhanit, të prodhuesve të vendit ose të importit, të pranishme në tregun shqiptar, tregtohen vetëm me pullë fiskale, të ngjitur në ambalazhin përdorues, nën letrën e tejdukshme të paketës.”

7. Ndryshime në Kreun e shkeljeve në fushën e akcizës dhe sanksionet.

➤ Efektet e pritshme në buxhet

Sipas përcaktimeve në relacionin që shoqëron projektligjin, miratimi i ndryshimeve që propozon projektligji do të sjellë një efekt pozitiv prej afërsisht në masën +144 milionë lekë.

II. PROCESI I SHQYRTIMIT NË KOMISIONIN PËR VEPRIMTARITË PRODHUESE, TREGTINË DHE MJEDISIN

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrtoi projektligjin në mbledhjet e datave 6,7,8, 9 dhe 13 nëntor 2018.

Të pranishëm në mbledhjet e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’ju përgjigjur pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Pas prezantimit të detajuar të projektligjit nga relatori i caktuar nga Komisioni, përfaqësuesit e ministrisë në mënyrë të përmbledhur prezantuan synimet e projektligjit, argumentuan në aspektin e politikave fiskale ndryshimet e propozuara dhe efektet e pritshme që këto ndryshime do të kenë në buxhetin e shtetit.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, Komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të disa grupeve të interesit, si më poshtë:

- **Shoqata Shqiptare e Investitorëve të Huaj (FIAA)**

Përfaqësuesit e kësaj shoqate paraqitën shqetësimet e tyre lidhur me:

- Vendosjen e akcizës prej 1 lekë/kg për zhavorrin bituminoz duke argumentuar që kjo përbën rreth 32% të çmimit të produktit dhe kjo rritje do të bëjë që fabrikat e çimentove që janë përdorues të zhavorrit bituminoz të drejtohen drejt produkteve të tjera siç është koksi i naftës, si dhe do të çojë drejt mbylljes bizneseve që operojnë në karrierat e Selenicës.
- Rritjen e akcizës së kromit nga 6 në 9%. Duke qenë se kapaciteti përpunues në vend është i kufizuar, kjo bën që tepricat t'i drejtohen importit duke u bërë kështu subjekt i një akcize prej 9%. Sipas Shoqatës kjo do të bëjë që të ulët sasia e nxjerrjes së kromit duke penalizuar më shumë subjektet e vogla të nxjerrjes së kromit.

• **Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas**

Përfaqësuesit e kësaj shoqate paraqitën propozimet e tyre për shëndoshjen e situatës financiare të bizneseve dhe njëkohësisht edhe për rritjen e cilësisë së shërbimit. Ata propozuan të bëhet një ndryshim në projektligj lidhur me heqjen e akcizës ose taksës së qarkullimit për karburantin e përdorur për shërbimin e transportit qytetës, duke argumentuar se nëse do të hiqet akciza efekti neto në buxhetin e shtetit llogaritet në rreth 280 milion lekë, ndërsa po të hiqet taksa e qarkullimit efekti neto në buxhetin e shtetit llogaritet në rreth 250 milion lekë.

Në diskutimet e tyre për këtë projektligj anëtarët e komisionit u fokusuan kryesisht në çështjen e vendosjes së akcizës në masën 1 lekë/kg për zhavorrin bituminoz, duke marrë shkas edhe nga shqetësimet e ngritura nga shoqata e investorëve të huaj. Anëtarët e Komisionit diskutuan rreth problematikave që kanë shkaktuar ndryshimet e shpeshta që kanë ndodhur në legjislacionin fiskal, lidhur me akcizimin e këtij produkti, gjatë viteve të fundit. Është konstatuar se veçanërisht ndryshimi që është bërë në vitin 2016 ka penalizuar subjektet që veprojnë në këtë fushë, duke bërë që të ndërpritet prodhimi në fabrikat e çimentos, në të cilat zhavorri bituminoz përdoret si lëndë djegëse dhe subjektet që veprojnë në këtë sektor janë detyruar t'i drejtohen importit. Me qëllim përkrahjen e industrisë vendase, deputetët diskutuan mundësinë e uljes së vlerës së akcizës për këtë produkt nga 1 lekë/kg në vlerën 0,3 – 0,5 lekë/kg. Aktualisht me propozimin e projektligjit me 1 lekë/kg, vlera e akcizës përbën rreth 32% të çmimit të produktit.

Gjithashtu, anëtarët e komisionit diskutuan edhe mbi rrezikshmërinë që paraqesin fishekzjarret dhe ndotjen që shkakton në mjedis përdorimi i tyre dhe për këtë qëllim propozuan që të mos hiqet akciza për këtë produkt. Gjithësesi, këto propozime mbeten të hapura për t'u diskutuar në fazën e shqyrtimit nën për nen të projektligjit.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni u shpreh dakord, në parim, për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm.

RELATOR

KRYETAR

Ilir BEQAJ

Eduard SHALSI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 23.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 61/2012, “PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

(shqyrtimi nen për nen)

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 23 nëntor 2018, shqyrtoi nen për nen projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”,”,

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrton këtë projektligj bazuar në Kalendarin e posaçëm të Kuvendit për shqyrtimin e projektbuxhetit të shtetit të vitit 2019 dhe projektligjeve financiare që kanë lidhje me të.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit ishin përfaqësues të ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Projektligji synon :

- Ndryshimin e nivelit të akcizës për produktin e duhanit të grirë, purot, cigarillos dhe cigaret me zëvendësues duhani;
- shtimin e një produkti të ri “duhan me ngrohje”, në listën e mallrave të akcizës;
- heqjen nga lista e mallrave të akcizës fishekzjarrët, llambat, pilat/bateritë dhe rëra bituminoze;
- vendosjen e akcizës për produktin “zhavorr bituminoz”;
- saktësimin e metodës së përlllogaritjes së akcizës për produktin nikotinë lëng për mbushjen e cigareve elektronike;
- ndryshime në Kreun e shkeljeve në fushën e akcizës dhe sanksionet.

Sipas përcaktimeve në relacionin që shoqëron projektligjin, miratimi i ndryshimeve që propozon projektligji do të sjellë një efekt pozitiv prej afërsisht në masën +144 milionë lekë.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision, deputetët u fokusuan kryesisht në çështjen e masës së akcizës për zhavorrin bituminoz, duke marrë shkas edhe nga shqetësimet e ngritura nga shoqata e investitorëve të huaj në seancën dëgjimore që zhvilloi Komisioni gjatë fazës së shqyrtimit në parim. Anëtarët e Komisionit diskutuan rreth problematikave që kanë shkaktuar ndryshimet e shpeshta që kanë ndodhur në legjislacionin fiskal, lidhur me akcizimin e këtij produkti, gjatë viteve të fundit, të cilat kanë penalizuar subjektet që veprojnë në këtë fushë, duke bërë që të ndërpritet prodhimi në fabrikat e çimentos në të cilat zhavorri bituminoz përdoret si lëndë djegëse. Me qëllim përkrahjen e industrisë vendase, deputetët mbështetën propozimin për uljen e vlerës së akcizës për këtë produkt nga 1 lekë/kg në vlerën 0,3 – 0,4 lekë/kg.

Gjithashtu, për shkak të rrezikshmërisë që paraqesin fishekzjarrët dhe ndotjes që shkakton në mjedis përdorimi i tyre, anëtarët e komisionit mbështetën propozimin që të mos hiqet akciza për këtë produkt.

Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni vendosi t'i paraqesë Komisionit për Ekonominë dhe Financat propozimet si më poshtë:

Në shtojcën nr. 1, që shoqëron projektligjin, të bëhen këto ndryshime:

1. Për produktin zhavorr bituminoz, me kodin NK 27 14 90 00, shkalla e taksimit të bëhet 0,4 lekë/kg.
2. Të shtohen fishekzjarrët në listën e mallrave të akcizës, në Kategorinë F000.
3. Në nenin 6 që shton nenin 94/1, neni 94/1 të riformulohet si më poshtë:

“Neni 94/1

Tepriat ose mangësitë në pullat fiskale mbi 2% të konstatuara gjatë kontrollit të operatorëve ekonomik, në rastet kur nuk janë depozitues të miratuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës, që duheshin paguar për produktet e akcizës të konvertuara në sasi të përkatëse.”.

RELATOR

KRYETAR

Ilir BEQAJ

Eduard SHALSI